Nr. i Prot. 70-2/24
Data: 15.01.24
Nr. i faqeve: -02-
Njësia org.: 11
PRISHTINË / A No.1

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada – Government**

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës***
***Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture***
***Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrri,<br>Melihate Basholli - Latifi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë | |
| Kopje: | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL<br>Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Liburn Aliu, Ministër i MMPHI<br><br>Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI | |
| Nga: | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor | Nr.VL-08/24<br>Datë:09.01.2024 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit | |
| Lënda: | Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal | |
| Lloji i aktit: | Vendimi Nr.287/23 për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032, miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë | |

I nderuar kryetar Idrizi,
E nderuar kryesuese Basholli – Latifi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me datë 05.01.2024, ka pranuar nga MAPL Vendimi Nr.287/23 për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032, miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, datë 28.12.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim më Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë:

**RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT**

Vendimin Nr.287/23 për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032, miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, datë 28.12.2023.

**ARSYETIMI**

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimi Nr.287/23 për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032, miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, konstatoi se:

Programi i punës për hartimin dhe menaxhimin e Planit Zhvillimor Komunal duhet të fshihet gjithashtu në vend të *"kompania konsulentë"* duhet të jetë Autoriteti përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor – Drejtoria e Urbanizmit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Vushtrrisë dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.